



Dr. Ilir Muharremi

Arti Ballkanik me atë të Ukrainës

Vërtetësia jetësore është kusht themelor që idetë bëhen estetike

Arti i aktualizimit i Sislej Xhafës¹

E bukura e adhurar shpreh natyrën personale, karakterin saktësisht zakonet e artistit, prandaj është personalitet që në mënyrë arbitrare identifikohet me ndjeshmërinë. Arti është ngacmim, provokim, sinqeritet, trans, shpirt, dhimbje, dehje, ekstazë dhe në kuptim të gjerë iluzion real i objektivizmit dhe subjektivizmit. Ideja dhe koncepti rrënjësisht ballafaqohen me kreativitetin në art, japin atë sasinë e iluzionit të dëshiruar që përshkon me çdo adhurim estetik. Ballkani, Evropa dhe SHBA-ja janë vërshuar me rryma, lëvizje, koncepte të ndryshme të artistëve. Pa dyshim duhet përmendur vizionarin, legjendarin, apo provokuesin më të madh të artit konceptual Sislej Xhafën, i cili tronditi botën, me një art provokativ, domethënës, revolucionar, të një zhanri apo teknike që përkon me ndijimin e pjesërishëm të pandashëm me personalitetin e tij.

¹ Info: http://en.wikipedia.org/wiki/Sislej_Xhafa

Polemikat, kureshtjet u vërshuan qysh në vitin 2003, kur artisti Xhafa me veprën “Padre Pio” u shfaq në ekspozitën “The Nature of Art” në San Lorenzo. Kjo vepër bëhet provokuese ngase në thelb prekë fenë dhe figurën paksa të karikuar të Pios. Artsiti tregon guxim, zellë, karakter të fortë, një kritikë të gjykimit dhe mesazhi adresohet tek shenjtorët të cilët gjithnjë ruajnë, kontribuojnë marrëdhënie me realitetin, dhe kjo njerëzve ua zbukuron jetën. Tjetër çka e karakterizon këtë vepër gjigante është se kur mungon kreativiteti në politikë, ekonomi, dominon papunësia, andaj oferta më e mirë është e turizmit religjioz. Shikuesi pa hezitim mund të futet në kokën e Pios dhe të vështror botën, ashtu si e ka vështruar Pio, ky është një element tjetër që e faktorizon këtë vepër madhështore. Religjioni ende mbetet pyetja dhe përgjigja më e madhe në globin tonë. Ekonomia është triumf më i madh, nga e cila rrodhën vuajtjet. Krentonti në antikë thoshte: “Gjënë më të keqe që shpiku njeriu është paraja”. Për paranë, shkrijmë ndjenjat, lotët, ritmin e zemrës, i nënshtrohemi me të gjitha forcat, për ta kapur dhe dominuar botën. Mirëpo, qetësia shpirtërore adresohet tek religjioni. Më e logjikshme do ishte të meditohet në vetën e parë, dhe të arrihet kulminacioni individual i personalitetit. Vepra tjetër e Xhafës e vendosur në parkun e Cyrilut, Hardaupark në formën e “Y”psilon, e lartë 16 metra, e ngritur në formë skulpturale, një objekt me pamje të llastiqeve² gjigante. Gypa të mëdhenj, të gjerë të shtrirë mbi tokë, pranë tyre një vrimë e zezë. Mos punëtorët paskan hasur në naftë dhe tash po i vendosin gypat e bartjes? "Pse jo", thotë përgjegjësi i gjithë kësaj, Xhafa.

Ai ndjehet mirë që njerëzit e interpretojnë artin e tij në mënyra të ndryshme. "Unë mësoj me kënaqësi nga kjo". Artisti prodhon artin e plason në treg, konsumatori brendh nëpër të, konsumon produktin më të mirë dhe më të përafërt me ndjenjat e tija. Triumf më i zakonshëm i veprave konceptuale qëndron në faktin që t'i shprehin nuancat e kapshme por, në disa raste edhe të pakapshme dhe të paformësuar, përmes imazheve të rrepta ose kundërthënëse. Si p.sh : forma, përmbajtja, mendimi apo materia. Karakteri, inteligjenca ana intime, aktualiteti, karakterizojnë krijuesin Xhafa nëpër punën e tij. E veçanta e një videoje, në të cilën dominon figura e vet krijuesit Xhafa, është se një person³ tinëzisht fut dorën në xhep të një personi, me tentim për të vjedhur. Qëllimi i punimit është të theksohet se “hajnia” është profesion. Sikurse një jurist, mjek, avokat që ka

² armë fëmijësh

³ hajdut

profesionin e tij, po ashtu edhe hajduti ka këtë profesion. Kemi edhe video artin tjetër të prekshëm të Xhafës, ku shihen dy homoseksualë, duke luajtur në një fontanë të mbushur me ujë. Gjatë gjithë lojës, ata nuk i përmbajnë ndjenjat për njëri tjetrin, dhe shprehin publikisht puthjet. Kuptimi fshihet pas asaj se secili njeri, qoftë intelektual, hajdut, mjek, mbinjeri, gjykatës, ka kënaqësinë, vuajtjen, lojën, dëshirën, shpresën, dhe të gjitha këto i plason në këtë botë. Njerëzit i bëjnë rregullat dhe duhet të ketë rregulla për çdo person. Andaj, nga gjithë kjo që u tha, do e rumbullakoj se arti i kosovarit Sislej Xhafa, prezanton një kulturë ballkanase, të shtypur, të vuajtur, gjithnjë të luajtur nga dikush tjetër. Apo e bukura arkitektonike, nuk është seksion i artë që teorikisht vlen kudo, po me radhë ajo është kurorë, hark i plotë, i mprehtë, vijë valëvitëse, e tendosur e stileve moderne, simetri, desimetri që shkon me evolucionet e një pëlqimi universal.

NE KOPIRAN

PR
DIOGEN pro kultura
<http://www.diogenpro.com>